



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
KRYETARI

Nr. 350/8 Prot.

Tiranë, më 06.10.2022

Lënda: Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin me objekt “Auditim Përputhshmërie”

Drejtuar: Zj. Lindita NIKOLLA
KRYETAR I KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

TIRANË

Në auditimin e ushtruar në institucionin e Kuvendit të Shqipërisë, me objekt “Mbi auditimin e përputhshmërisë, për periudhën 01.01.2017 deri më 30.04.2022, mbi shkallën e zbatueshmërisë nga subjekti të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, u konstatua se në përgjithësi veprimtaria e institucionit është kryer në përputhje me kuadrin ligjor dhe aktet nënligjore në fuqi dhe se nuk janë konstatuar të meta dhe mangësi në funksionimin e komponentëve të sistemit të kontrollit të brendshëm, që justifikon dhënien e një opinioni të pa kualifikuar për përputhshmërinë.

Bazuar në nenet 6, 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe **Vendimin nr.190, datë 04.10.2022, të Kryetarit të KLSH-së**, për përmirësimin e gjendjes, ju rekomandojmë zbatimin e masave të mëposhtme:

A. OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i pamodifikuar/pakualifikuar¹.

Mbështetur në, ISSAI 4000 “Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Përputhshmërisë”, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH dhe Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së institucionit Kuvendi i Shqipërisë me kriteret e vlerësimit përfshirë kuadrin ligjor, rregullat, rregulloret dhe marrëveshjet që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të këtij institucioni.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se veprimtaria e institucionit të Kuvendit të Shqipërisë, në të gjitha aspektet është kryer në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator në fuqi dhe justifikon dhënien e një “Opinionit të Pakualifikuar”.

¹ 1 -Referuar Manualit të Auditimit Përputhshmërisë të KLSH-së, (Qershor 2020, fq.104), Kapitulli VII, pika 7.3.3 “Angazhimet e Vërtetimit me Siguri të Arsyeshme”, Konkluzionet/ Opinonet e pakualifikuara: “Kur nuk janë gjetur apo konstatuar raste të mospërputhjeve materiale në një angazhim të sigurisë së arsyeshme, audituesi shpreh opinion të pamodifikuar ose të pakualifikuar që informacioni i përgatitur, është në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e aplikueshme”.

Baza për opinionin e pamodifikuar/pakualifikuar të përputhshmërisë:

Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik (ISSAIs). në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të zbatueshme për Institucionet Supreme të Auditimit (ISSAIs), në parimet INTOSAI-P1, “Deklarata e Limës”; INTOSAI P-10, “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe INTOSAI P-12, INTOSAI P-20, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin përputhshmërisë të një institucioni, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 4000 “Standardi i Auditimit të Përputhshmërisë”. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura, përfshirë këtu edhe Kodin e Etikës së KLSH-së, miratuar me Vendimin nr. 56, datë 30.04.2015, të Kryetarit të KLSH-së. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë në institucionet buxhetore, KLSH është i pavarur nga institucioni i audituar dhe përgjegjësitë janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Ne besojmë se dëshmitë e evidencës së auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për sigurimin e bazës për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjet nën auditim:

Strukturat drejtuese të Shërbimeve të Kuvendit janë përgjegjëse për zbatimin e veprimtarisë në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e zbatueshme dhe në fuqi.

Përgjegjësia e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për auditimin e përputhshmërisë”, pjesë e raportit përfundimtar të auditimit. Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin dhe i përshkruajmë ato në materialet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur sipas përcaktimeve ligjore është vendosur që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN DHE AKTET NËNLIGJORE NË FUQI:

1. Gjetje nga auditimi:

Nevoja e rishikimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore dhe akteve nënligjore mbi statusin dhe trajtimin financiar të deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë, duke u mbështetur në praktikat dhe modelet më të mira të vendeve evropiane si dhe reflektuar ndryshimet e mjedisit të kontrollit të brendshëm në vend. Sipas vlerësimit të grupit të audituesve të KLSH, mungon harmonizimi mes ligjit nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", i ndryshuar dhe Vendimit të Kuvendit nr. 114/2014, datë 24.12.2014 "Për mënyrën e trajtimit të deputetëve" i ndryshuar, me parashikimet e legjislacionit tatimor në fuqi (ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006 "Për Tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar, të Ministrisë së Financave).

Nga ana e institucionit të Kuvendit mbulohen kompensimi i shpenzimeve mujore për çdo deputet, në bazë të nenit 19, të ligjit Statusi i Deputetit. Rezulton se, Vendimi nr. 114, datë 24.12.2014, nuk i është nënshtruar asnjë rishikimi për një periudhë prej më shumë se 7 vitesh nga data e miratimit të kësaj dispozite nga vetë Kuvendi. Mungon përcaktimi në mënyrë definitive në këtë ligj ose në Vendimin nr. 114/2014, datë 24.12.2014, (dalë në zbatim të tij), duke u shprehur, lidhur me faktin nëse:

- a. deputetët e Kuvendit duhet të përfitojnë pagën dhe përfitimet financiar për rastet e bojkotimit të punimeve të Kuvendit pas fitimit të mandatit, si pasojë e vendimmarrjes politike të një partie apo e një grupi parlamentar, dhe
- b. deputetët e Kuvendit, duhet të përfitojnë trajtim financiar, në lidhje me kategoritë të tilla si dieta, karburant etj. në periudhën ndërmjet sesioneve parlamentare, apo gjatë periudhës së fushatave zgjedhore, edhe në referim të vendimi nr. 74, datë 25.02.2021 të Byrosë së Kuvendit, pasi si rregull, Kuvendi në këto kohë nuk zhvillon punime.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 29-41 të Projekt Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi:

Të merren masat e përmirësimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor në fuqi mbi statusin, trajtimin financiar dhe kompensimin e shpenzimeve për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë, duke u mbështetur në praktikën dhe modelet më të mira të vendeve evropiane si dhe reflektuar ndryshimet e mjedisit të kontrollit të brendshëm në vend.

Për këtë, të gjejnë përcaktimin në ligjin nr. 8550, datë 18.11.1999 "Statusi i deputetit", i ndryshuar, ose të bëhen përmirësimet e nevojshme në Vendimin e Kuvendit nr. 114/2014, datë 24.12.2014, duke u shprehur në mënyrë përfundimtare në kuadër të trajtimit financiar të deputetëve të Kuvendit, lidhur me faktin nëse:

- a. deputetët e Kuvendit duhet të përfitojnë pagën dhe përfitimet financiar për rastet e bojkotimit të punimeve të Kuvendit pas fitimit të mandatit, si pasojë e vendimmarrjes politike të një partie apo e një grupi parlamentar, dhe
- b. deputetët e Kuvendit, duhet të përfitojnë trajtim financiar, në lidhje me kategoritë të tilla si dieta, karburant etj. në periudhën ndërmjet sesioneve parlamentare, apo gjatë periudhës së fushatave zgjedhore, edhe në referim të vendimi nr. 74, datë 25.02.2021 të Byrosë së Kuvendit, pasi si rregull, Kuvendi në këto kohë nuk zhvillon punime.

Afati: Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionimit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, e miratuar me vendimin nr. 42, datë 16.07.2015, i ndryshuar, të Byrosë së Kuvendit, në disa nene të saj nuk është e harmonizuar me kuadrin ligjor, standardet dhe kërkesat profesionale mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik. Për rrjedhojë, ngritja dhe organizimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm nuk është bërë në përputhje me kriteret e përcaktuara në Nenin 10, "Organizimi i shërbimit të auditimit të brendshëm", kreu IV, të ligjit 114/2015, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik"; pikën nr.3, të VKM nr.83, datë 3.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik", të ndryshuar; ligjin nr.90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe pikën nr.22, të VKM nr.893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e rregullave të organizimit dhe funksionimit të kabinetëve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm". Njësia e Auditimit në strukturë nuk përgjigjet dhe raporton përpara Titullarit të Njesisë Publike, ose Byrosë së Kuvendit, por tek Nëpunësi Autorizues i institucionit.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 68-83 të Projekt Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi:

Të rishikohet dhe përmirësohet Rregullorja e Organizimit dhe Funkcionit të Shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, miratuar me Vendimin nr. 42, datë 16.07.2015 të Byrosë së Kuvendit, e ndryshuar, përkatësisht në:

- Nenin 12/3, që përcakton se: "Pranë Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm funksionon Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Projekteve";
- Nenin 14/1, "Mbikëqyrja, ndihma dhe kontrolli nga eprori", që përcakton se: "Njësia e Auditit të Brendshëm dhe Sektori i Projekteve janë struktura që raportojnë direkt te Sekretari i Përgjithshëm";
- Nenin 16 "Auditi", që parashikon se: "1. Shërbimi i Auditit përgatit Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit, i cili miratohet nga Sekretari i Përgjithshëm. Pas miratimit, Shërbimi i Auditit ia njofton atë Ministrisë së Financave, brenda datës 15 tetor të çdo viti. 2. Plani Strategjik dhe Vjetor i Auditimit analizon fushat apo çështjet që paraqesin risk më të lartë për institucionin e Kuvendit dhe planifikon kontrole auditimi duke u siguruar mbulimi i zonave me risk. Ky plan pasqyron edhe nevojat për trajnime të Njesisë së Auditimit. 3. Njësia e Auditit të Brendshëm ushtron kontrole të plota pranë Shërbimit të Financës dhe Buxhetit, Shërbimit të Burimeve Njerëzore dhe Trajtimit të Deputetëve, Sektorit të Prokurimeve, Shërbimit të Transportit. 4. Pas çdo kontrolli, Njësia e Auditit të Brendshëm i raporton me shkrim Sekretarit të Përgjithshëm, për gjetjet dhe rekomandimet për shërbimet që auditohen. 5. Njësia e Auditit të Brendshëm, me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm, kryhen auditime të tjera të posaçme."

Afati: Në vijimësi

C. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi:

Pasaktësi në evidentimin në kontabilitet të vlerës së ndërtesave, që sipas përcaktimeve të VKM nr. 324, date 16.05.2012 janë pjesë e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Në pasqyrat financiare të mbyllura më 31.12.2020 dhe 31.12.2021, Aktivet Afatgjata Materiale pasqyrojnë vetëm vlerat e investimeve për rikonstruksioneve të kryera në këto tre objekte ndërtimore. Kjo ka ndodhur, pavarësisht marrjes së masave nga administrata dhe shërbimet e institucionit të Kuvendit. Procedurat e transferimit dhe dorëzimit fizik të aktivitet afatgjatë material "Ndërtesa" janë kryer sipas përcaktimeve në Vendimin e Këshillit të Ministrave, mirëpo mungojnë të dhënat mbi vlerën kontabile të godinës, me qëllim kontabilizimin e saj në Pasqyrat Financiare të institucionit të Kuvendit të Shqipërisë. Si rrjedhojë, Pasqyrat Financiare të llogaridhënies për zërin "Ndërtime e konstruksione", kanë regjistruar vlerën prej 246,403 mijë lekë, që i përket vetëm vlerës së rikonstruksioneve të kryera ndër vite. *(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 42-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

1.1 Rekomandimi:

Duke patur parasysh rëndësinë e këtij procesi për të pasqyruar vlerën e drejtë të këtyre aktiveve në pasqyrat financiare të institucionit, pasaktësitë e informacionit të mbartur dhe trashëguar të Kuvendit të Shqipërisë për vlerën e këtyre godinave, Sekretari i Përgjithshëm duhet të sigurojë që objektet ndërtimore në administrim të institucionit të Kuvendit të pasqyrohen me vlerën e drejtë e të saktë në kontabilitetin e institucionit. Për sa sipër, Sekretari i Përgjithshëm të marrë masat për kryerjen e një procesi vlerësimi të pavarur, me qëllim përcaktimin e vlerës aktuale të këtyre aktiveve, për t'a pasqyruar dhe për ta sjellë vlerën e tyre të drejtë në kontabilitet në llogarinë 212 "Ndërtesa" në përputhje me kërkesat e Standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 16 "Aktivet Afatgjata Materiale (toka, ndërtesa, makineri e pajisje)" dhe nga ana e Nëpunësit Zbatues të kryhen regjistrimet e vlerës së re të aktiveve të institucionit.

Afati: Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi:

Nuk është evidentuar e regjistruar në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të periudhës së audituar 2017- 2021, vlera e trojeve në administrim të institucionit, aspekte këto që ndikojnë në funksionimin e sistemit të kontabilitetit dhe pasqyrimin me vërtetësi dhe saktësi të gjendjes së llogarive të bilancit kontabël për institucionin e Kuvendit
(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4 , faqe 42-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2. Rekomandimi:

2.1. Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Shërbimit Administrativ të ngrejnë një grup pune me qëllim identifikimin me planimetri dhe genplane të sipërfaqes së tokës truall që i përket institucionit dhe pas përlllogaritjes së vlerave nga ekspertët e fushës, të ndërmerren veprimet e nevojshme të regjistrimit të saj në kontabilitet, duke evidentuar situatën e duhur në pasqyrat financiare të institucionit dhe në pajtueshmëri me legjislacionin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare.

2.2. Për një pasqyrim të drejtë në kontabilitet të vlerës së tokave, trojeve dhe terreneve në pronësi dhe administrim të Kuvendit, bëhet domosdoshmëri azhurnimi, rakordimi dhe pasqyrimi në kontabilitetin e Kuvendit i vlerave të këtyre pasurive bazuar në informacionin e administruar nga vlerësuesi i pavarur.

Afati: Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi:

Gjendja e lartë e mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm. Në magazinën e Parkut të Kuvendit që nga fundi i vitit 2017 përfshihet gjendja e 754 artikujve, në vlerën 9,477,167 lekë mbi nevojat dhe që nuk përdoren për shkak të pakësimit të numrit të mjeteve në dispozicion të Kuvendit. (Këtu përfshihen kryesisht pjesë këmbimi të blera në vitet 2008-2010, kur ky institucion kishte në inventar 185 automjete). Sipas të dhënave që disponon Shërbimi i Transportit të Kuvendit kjo situatë lidhet me faktin që është pakësuar numri i mjeteve në dispozicion të Kuvendit, në zbatim të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë” dhe VKM nr. 1139, datë 24.11.2009 “Për përcaktimin e numrit të automjeteve dhe të shoferëve në dispozicion të ministrive, dhe të institucioneve qendrore”, i shfuqizuar, si dhe për faktin se disa tipe mjeteve në zbatim të vendimeve të Byrosë së Kuvendit, janë hequr nga shfrytëzimi në vitin 2003, ndaj rrjedhimisht këto aktive bëhen të pa shfrytëzueshme dhe janë ndjekur procedurat administrative për transferime e kalim kapital.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi:

Institucioni i Kuvendit të marrë masat dhe të rikërkojë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Kryeministrisë, autorizimin për fillimin e procedurave për shitjen me përparësi nëpërmjet ankandit publik të këtyre pjesëve të këmbimit, mallrave stok dhe me qarkullim të ngadalshëm, duke i trajtuar si “objekte të tjera, pronë publike” në kuptimin e nenit 4, të ligjit nr.9874, datë 14.2.2008, “Për ankandin publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se “Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonomisë, autorizon shitjen nëpërmjet ankandit publik edhe për objekte të tjera, pronë publike”, me qëllim rritjen e të ardhurave të institucionit dhe të rikuperimit të fondeve të ngurtësuara të aktiveve qarkulluese.

Afati: Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 5,690,584 lekë, shifër kjo e njëjtë me atë të vitit ushtrimor paraardhës 31.12.2020, por e pakësuar ndaj

vitit 2019 ku gjendja e kësaj llogarie paraqitet për 7,542,625 lekë. Konstatohet se mbi 90% e kësaj llogarie përfaqëson detyrimin e pa mbledhshëm, të mbartur prej vitesh si dhe shumë debitorë, kontabilizuar si detyrim për tu mbledhur, ku pjesa më e madhe e këtyre detyrimeve i përkasin periudhës 2000-2017 dhe 70.4 % e detyrimeve debitorë të institucionit janë të vitit 2000.

Llogaria 486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme" paraqet detyrimin e Kuvendit ndaj kreditorëve, në ekzekutim të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Vlera 2.850 mijë lekë, e cila ka si kundërparti në pasiv, llogarinë 467 "Kreditorë të ndryshëm", pasqyron tepricën kreditore të detyrimit më 31.12.2021 për 3 kreditorë gjyqfitues, kurse për vitin 2020 detyrimi prej 15,402 mijë lekë u përkiste 5 kreditorëve të institucionit. Domosdoshmëria e marrjes së masave, për të kërkuar në rrugë ligjore dhe administrative arkëtimin e të drejtave mbi debitorët si dhe për shlyerjen e të gjithë detyrimeve kreditore që ka institucioni kundrejt të tretëve, veprime në papajtueshmëri me gerrat "g" dhe "gj", neni 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.4, faqe 42-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. Rekomandimi:

4.1. Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë të marrë masat e duhura për kryerjen e një analize të thelluar të gjendjes së debitorëve dhe rritjes së detyrimeve ndaj furnitorëve, me qëllim nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive të rritjes së tyre. Gjithashtu të marrë masa të menjëhershme dhe plane konkrete për ndjekjen dhe të vendosin në kushtet e arkëtimin vlerat e debive të regjistruara në kontabilitet sidomos në kushtet që një pjesë e madhe e tyre kërcënohen nga risku i parashkrimit.

Të merren masat që të evidentohen në mënyrë kontabël, të gjitha detyrimet financiare të angazhimit dhe ato të konstatuara në zbatim të kërkesave ligjore, me qëllim njohjen e detyrimeve financiare në kohën e krijimit, programimin e likuidimit të detyrimeve ndaj të tretëve dhe zvogëlimin e borxhit financiar, sidomos për kreditorët gjyqfitues dhe detyrimet e papaguara të kuotizacioneve të prapambetura kundrejt organizatave ndërkombëtare.

Nëpunësi zbatues, të marrë masat që të dërgohen shkresa zyrtare dhe nga Shërbimet e Kuvendit të kërkohej në rrugë gjyqësore arkëtimi i debive nëpërmjet ngritjes së padisë për këtë qëllim për arkëtimin e detyrimeve, për debitorët që janë me shpresë arkëtimi, ndërsa për debitorët që janë pa ndonjë shpresë arkëtimi, ti propozohet Ministrisë së Financave që ti mbajnë në llogaritë jashtë bilancit, ose të ndiqet procedurat ligjore për parashkrimin e tyre.

4.2. Të hartohet dhe miratohet Gjurma e Auditimit për ndjekjen, regjistrimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për institucionin e Kuvendit të Shqipërisë. Shërbimi i Financës dhe Buxhetit, në çdo rast, me marrjen dijeni për vendimet gjyqësore të formës së prerë në favor të ish-punonjësve të larguar padrejtësisht nga puna, të marrin masat për likuidimin në kohë të këtyre detyrimeve që lindin nga vendimet gjyqësore të formës së prerë dhe mos lejojnë krijimin e kostove shtesë apo shpenzimeve të panevojshme për pagesat e përmbaruesve gjyqësorë. Kjo në përputhje me procedurat e parashikuara në ligjin nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimin e Këshillit të Ministrave nr.2, datë 18.08.2011 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". Në këtë kuadër, të merren masat për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë për kreditorët e pa përfshirë në data bazën e vendimeve gjyqësore të institucionit të Kuvendit, duke kryer përlllogaritjet e detyrimit financiar për çdo rast. Vlera e këtyre detyrimeve të regjistrohet në kontabilitet dhe të evidentohet në pasqyrat financiare të institucionit.

Afati: Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Parregullsi në kryerjen e inventarizimit vjetor të aktiveve afatgjata për periudhën objekt auditimi. Për periudhën objekt auditimi, procesi i kontrollit të ekzistencës fizike të aktiveve është shtrirë në disa muaj, duke e vështirësuar verifikimin dhe rakordimin e të dhënave të inventarit sipas një date të caktuar, me qëllim për ta kryqëzuar më tej informacionin e të dhënave të bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare me atë të rezultuar nga inventarizimi i gjendjes fizike të aktiveve.

Për periudhën objekt auditimi, inventarizimi i përgjithshëm i pasurisë nuk ka përfshirë inventarizimin e fondeve të Bibliotekës së Kuvendit, ku sipas pasqyrimit në llogari, të evidentuara për vlerën prej 14,916,671 lekë. Biblioteka e institucionit është organizuar dhe funksionon sipas “Rregullores së Bibliotekës së Kuvendit Popullor”, miratuar në vitin 1993 nga ish-Kryetari i Kryesisë së Kuvendit. Kjo rregullore në nenin 7 “Detyrat kryesore të kabinetit të fondit dhe bibliografisë”, ka përcaktuar “Pranimin dhe inventarizimin e të gjithë materialeve që hyjnë në bibliotekë” dhe në nenin 8 “Rregullat e administrimit të materialeve të fondit” është shprehur se “Mban librin e inventarit sipas modeleve të miratuara nga Këshilli i Bibliotekës”. Nga auditimi konstatohet se ky dokument nuk është i plotë dhe i përditësuar me kuadrin e mirë menaxhimit financiar publik dhe menaxhimit të aktiveve në njësitë e sektorit publik.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.3, faqe 30-41 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5. Rekomandimi:

5.1. Institucioni i Kuvendit të marrë masat dhe të organizojë kryerjen e inventarizimit të përgjithshëm e vjetor të pasurisë së institucionit duke informuar rregullisht mbi rezultatet e këtij procesi Byronë e Kuvendit, si organizmi vendimmarrës për aspektin financiar dhe administrativ. Nga ana e Nëpunësit Autorizues dhe atij Zbatues të zbatohen procedurat për kontrollin një herë në vit të ekzistencës dhe vlerësimit të aktiveve afatgjata materiale, duke përfshirë verifikimin dhe kontrollin e ekzistencës fizike nëpërmjet inventarizimit të përvitshëm të gjendjeve të inventarit të Zyrave Zgjedhore në qarqe, inventarizimin e fondeve të Bibliotekës, të Sallës së Seancave Plenare etj. Për diferencat eventuale të konstatuara dhe për vlerat jashtë përdorimit nga inventarizimi, të nxirren përgjegjësitë përkatëse dhe të procedohet sipas ligjit për sistemimin e llogarive kontabël.

Afati: Në vijimësi

5.2. Të merren masa për rishikimin e dokumentit “Rregullore e Bibliotekës së Kuvendit Popullor”, e miratuar në vitin 1993, duke e harmonizuar me legjislacionin në fuqi për bibliotekat, librin dhe menaxhimit financiar e kontrollin, rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë, (miratuar më 16.7.2015), duke përcaktuar kritere dhe rregulla të qarta mbi kryerjen e inventarizimit vjetor e periodik të këtyre fondeve, klasifikimin, regjistrimin bibliografik, kriteret për dhurimin e materialeve bibliotekare apo huazimin e materialeve, etj., bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare në bazë të cilave punon shërbimi bibliotekar dhe kuadrin të Bibliotekës Kombëtare, me qëllim sigurimin e ekzistencës dhe mbrojtjen e këtyre aktiveve të institucionit.

Afati: Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi:

Nuk është hartuar e miratuar Strategjia e Menaxhimit të Risqeve për institucionin e Kuvendit për vitet 2021-2023 dhe nuk janë rishikuar e përditësuar nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik, Regjistrat e Riskut dy herë në vit, në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”.

(Hollësisht trajtuar në pikën nr.5, faqe 68-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6. Rekomandimi:

6.1. Nga ana e Shërbimeve të Kuvendit, të hartohet dokumenti i Strategjisë Afatmesme të Menaxhimit të Riskut për vitet 2022-2024 dhe në zbatim të përcaktimeve të nenit 8, “Byroja e Kuvendit”, të Rregullores së Kuvendit, miratuar me vendimin nr. 166, datë 16.12.2004, i ndryshuar, që përcakton se: “Byroja e Kuvendit është organi vendimmarrës për aspektin administrativ dhe financiar të Kuvendit dhe organeve të tij. Byroja garanton respektimin e parimeve të pavarësisë organizative, funksionale dhe financiare të Kuvendit si institucioni më i lartë përfaqësues e

ligjvënës dhe që bazohet në parimin e ndarjes e të balancimit të pushteteve”, ky dokument të paraqitet për miratim në Byronë e Kuvendit.

Afati: Në vijimësi

6.2. Shërbimet e Kuvendit të azhurnojnë dhe përditësojnë Regjistrin e Riskut për programe dhe objektiva specifike 2 herë në vit, në përputhje me kërkesat e pikës nr. 3.2.5 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.7.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike”.

Afati: Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi:

Njësia e Auditimit të Brendshëm e këtij institucioni në strukturë, nuk përgjigjet dhe raporton përpara Titullarit të Njesisë Publike, ose Byrosë së Kuvendit, por tek Nëpunësi Autorizues i institucionit, veprime jo në përputhje me kërkesat e standardeve dhe kërkesave profesionale mbi organizimin dhe funksionimin e shërbimit të auditimit të brendshëm të pavarur dhe eficient në sektorin publik

(Hollësisht trajtuar në pikën nr. 5, faqe 68-83 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1 Rekomandimi:

Nga ana e institucionit të Kuvendit të ndërmerren veprimet e nevojshme në funksion të rishikimit të strukturës organike të institucionit të Kuvendit², me qëllim harmonizimin e saj me përmasat dhe misionin e institucionit, vendosjen e një hierarkie të përshtatshme dhe të linjave të komunikimit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor në fuqi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e dërguara nga ana e Ministrisë së Financave.

Për sa sipër, Titullari i njësisë publike Kuvendi i Shqipërisë, të marrë masa konkrete, duke i propozuar Byrosë së Kuvendit rishikimin strukturor dhe riorganizimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (duke e organizuar atë së paku në nivel Sektorit), dhe pas miratimit të këtyre propozimeve të bëhet rishikimi i Kartës së Auditimit të Brendshëm, e miratuar me datën 01.12.2017 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, (pika nr. 6, pavarësia dhe objektiviteti).

Afati: Në vijimësi

D. VLERËSIMI I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE

Në zbatim të nenit 15, shkronja “j”, të ligjit nr. 154/2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” për masat e marra nga ana Juaj të përgatiten programe me

² -Rekomandimet e Raportit të SKB të Kuvendit, hartuar për v.2021, faqe 15.

afate dhe persona përgjegjës dhe për zbatimin e rekomandimeve të njoftohet Kontrolli i Lartë i Shtetit **brenda 20 ditëve** nga marrja e kësaj kërkesë.

Në vijim e në zbatim të nenit 30, pika 2 e këtij ligji, kërkohet ndjekja e realizimit të tyre në vazhdimësi duke nxjerrë aktet e nevojshme administrative dhe mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, nga ana Juaj të raportohet (me shkrim) pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit **brenda 6 muajve** nga marrja e njoftimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe rekomandimeve nga Institucioni i Kuvendit të Shqipërisë.

K R Y E T A R

Arben SHEHU

